

# RAPORT

**MBI INVESTIMET KAPITALE  
NGA MINISTRITË E LINJËS NË  
KOMPETENCAT KOMUNALE  
PËR PERIUDHËN**

2018 - 2020

**RAPORT MBI INVESTIMET KAPITALE  
NGA MINISTRITË E LINJËS  
NË KOMPETENCAT KOMUNALE  
PËR PERIUDHËN 2018 - 2020**

Gusht 2021

Ky raport është përgatitur nga RECURA Financials për projektin DEMOS,  
i cili zbatohet nga HELVETAS Swiss Intercooperation

**Mohim:** Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht  
qëndrimet e SDC-së dhe HELVETAS Swiss Intercooperation.

---

©DEMOS

Publikuar: Gusht 2021

Prishtinë, Kosovë

---

# Përmbajtja

1. Fushëveprimi i punës, metodologjia dhe qasja .....	7
2. Investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale .....	9
2.1. Investitorët më të mëdhenj në kompetencat komunale .....	12
2.2. Përfituesit më të mëdhenj të investimeve kapitale në kompetencat komunale .....	15
3. Proceset vendimmarrëse të ministrive të linjës për investimet kapitale në kompetencat komunale .....	19
3.1. Investimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në komuna .....	20
3.2. Investimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit në komuna .....	21
4. Përfundimet .....	23
5. Rekomandimet .....	25
Shtojca I - Investimet kapitale nga ministritë sipas komunave .....	27
Shtojca II - Investimet kapitale nga ministritë për komunë për kokë banori .....	28
Shtojca III - Shpenzimet kapitale të ministrive në fushat e kompetencave komunale .....	29
Shtojca IV - Shpenzimet kapitale të ministrive të linjës në kompetencat komunale si % e buxhetit të tyre për investime kapitale .....	30



## Përmbledhje ekzekutive

Gjatë tri viteve midis periudhës 2018-2020, ministritë e linjës të Kosovës kanë kryer investime kapitale në komuna në fushat që u përkasin kompetencave të qeverisjes lokale. Së bashku, 10 ministri të linjës kanë investuar 192.53 milionë € ose 64.17 milionë € në vit. Pothuajse gjysma e kësaj vlere është shpenzuar nga Ministria e Infrastrukturës si investitori më i madh në kompetencat komunale. Ajo u pasua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me 29.93 milionë € ose 15.5% të totalit.

Investimet janë kryer në 35 komuna, nga 38 në total. Përfituesi më i madh ishte komuna e Gjakovës e cila ka marrë 22.05 milionë € ose 11.5% të vlerës totale të investuar. Ajo u pasua nga komuna e Ferizajt me 20.72 milionë € ose 10.4% të totalit. Përfituesit e tretë dhe të katërt më të mëdhenj ishin Peja me 13.87 milionë € (7.2%) dhe Deçani me 13.385 milionë € (7.2%). Sa i përket vlerës së marrë për kokë banori, tre përfituesit më të mëdhenj ishin komuna e Junikut që ka marrë 428 € për kokë banori, e pasuar nga Deçani me 344 € dhe Gjakova me 233 € për kokë banori.

Në vitin 2018 ne patëm kryer një studim të ngjashëm të investimeve të tilla për vitet midis periudhës 2011-2017. Për këtë periudhë, ministritë e linjës kishin investuar në komuna pa procedura apo kritere zyrtare, gjë që rezultoi me një shpërndarje të pabarabartë të fondeve midis komunave. Për ta trajtuar këtë çështje, Ministria e Financave kishte përfshirë një paragraf në ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2019 dhe e përsëriti atë në vitet 2020 dhe 2021, duke kërkuar që ministritë e linjës të kryejnë investime bazuar në kritere të qarta, të drejta dhe transparente të miratuara më parë nga Qeveria.

Kështu, studimi ynë aktual është fokusuar në monitorimin e zbatimit të kësaj kërkesë buxhetore nga ministritë e linjës. Për këtë qëllim jemi përpjekur të organizojmë intervista në pesë ministri, megjithëse vetëm Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka pranuar këtë. Bazuar në atë intervistë dhe analizën plotësuese të të dhënave kemi zbuluar se vetëm MAPL-ja dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) kanë ndjekur procesin zyrtar të përzgjedhjes dhe kanë zbatuar kriteret transparente. Në përputhje me ligjin për buxhetin për vitin 2020, të dy ministritë kanë nënshkruar marrëveshje me komunat përfituese duke sqaruar rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e projekteve. Ne rastin e MAPL, komunat përfituese kanë kryer procesin e prokurimit, kanë nënshkruar kontratat dhe kanë monitoruar zbatimin e tyre. Ndërsa ministritë kanë mbikëqyrur zbatimin e projekteve dhe kanë vërtetuar dhe disbursuar pagesat për kontraktorët. Përderisa MEA (e mbështetur nga GiZ) ka kryer proceset e prokurimit dhe ka nënshkruar kontratat në emër të komunave përfituese pasi që kishin mungesë të kapaciteteve për t'i kryer vet këto procese.

Gjithashtu jemi përpjekur t'i intervistojmë ministritë e tjera të linjës por nuk u janë përgjigjur kërkesave tona. Gjithsesi, nuk kishte asnjë dëshmi të publikuar në dispozicion se ato minis-

tri kanë zhvilluar dokumentet udhëzuese në lidhje me procesin e përzgjedhjes së projekteve. Kështu, nuk kemi mundur të konfirmojmë nëse investimet e tyre në kompetencat komunale janë përzgjedhur në bazë të kriterëve specifike dhe transparente siç kërkohet nga ligjet përkatëse të buxhetit. Ka më shumë të ngjarë që ato ministri të kenë vazhduar t'i financojnë projektet duke ndjekur një proces jozyrtar, duke rritur kështu rrezikun për investime të pabarabarta nëpër komuna.

# 1. Fushëveprimi i punës, metodologjia dhe qasja

Studimi është fokusuar në analizimin e projekteve kapitale të kryera nga ministritë e linjës në komuna në fushat në kuadër të kompetencave komunale.

Studimi ka pasur dy objektiva kryesorë. Së pari, qëllimi ishte identifikimi i projekteve kapitale që janë planifikuar dhe investuar nga ministritë e linjës në kompetencat komunale për periudhën midis viteve 2018-2020 dhe krahasimi i modeleve me periudhën 2011-2017. Së dyti, për të përcaktuar nëse ministritë e linjës kanë zhvilluar dhe zbatuar kriteret për financimin e investimeve kapitale në komuna siç kërkohet nga ligji i buxhetit të Kosovës për vitet 2019 dhe 2020. Për t'i arritur objektivat, ne i kemi analizuar dhe vlerësuar:

- I. Projektet kapitale të investuara nga ministritë e linjës në kompetencat komunale për periudhën 2018-2020; dhe
- II. Procedurat e vendimmarrjes për dhënien dhe disbursimin e fondeve për investime kapitale nga ministrat e linjës në kompetencat komunale.

Për ta përcaktuar shumën totale të investimeve kapitale, kemi:

- Analizuar ligjet e buxhetit të Kosovës për ta identifikuar numrin e fondeve në dispozicion të ministrive të linjës për investime kapitale në kompetencat komunale,
- Analizuar të dhënat e thesarit të Kosovës nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) për t'i identifikuar shumat totale që secila ministri e linjës investoi në kompetencat komunale, në veçanti:
  - vlerën e projekteve kapitale të investuara në kompetencat komunale për periudhën 2018-2020
  - vlerën e projekteve kapitale të investuara nga secila ministri e linjës për periudhën 2018-2020, dhe
  - vlerën e projekteve kapitale të investuara në secilën komunë, në total dhe për kokë banoi, për periudhën 2018-2020.
- Analizuar raportin e DEMOS-it për investimet kapitale në kompetencat komunale për periudhën 2011– 2017.

Për të përcaktuar se si ministritë marrin vendime për investimet kapitale, ne kemi:

- Analizuar dispozitat përkatëse të ligjeve të buxhetit për vitet 2019 dhe 2020 në lidhje me investimet në kompetencat komunale.
- Pasur një takim me Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave në lidhje me aplikimin e kriterëve të investimeve transparente dhe specifike nga ministritë e linjës.
- Mbajtur një intervistë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për të kuptuar procesin e ndjekur nga ministria për përzgjedhjen dhe zbatimin e projekteve kapitale në kompetencat komunale, në veçanti:
  - Kush i përgatit, vlerëson dhe jep projektet dhe cilat kriterë zbatohen?

- Kush i menaxhon procedurat e prokurimit dhe kontratën?
- Kush monitoron zbatimin e projekteve dhe kush i pranon produktet e projekteve?
- Kush i ekzekuton pagesat?
- Analizuar rregullat dhe udhëzimet për grantin e performancës të përdorura nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (ish-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor)

Vlen të përmendet se kemi planifikuar të bëjmë intervista me zyrtarët përgjegjës në pesë ministritë më të mëdha investuese për sa i përket vlerës totale të shpenzuar në kompetencat komunale. Sidoqoftë, vetëm Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka pranuar kërkesën tonë për takim.


## 2. Investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale

Komunat e Kosovës marrin buxhetin për investime kapitale nga disa burime financiare. Ato marrin shumën më të lartë nga granti i qeverisë qendrore dhe të hyrat vetanake. Gjithashtu, disa komuna marrin grante të donatorëve, megjithëse ato japin një kontribut më të vogël në buxhetin e tyre të përgjithshëm kapital. Të gjitha këto fonde kapitale dhe projektet kapitale të lidhura me to menaxhohen drejtpërdrejt nga komunat.

Krahas burimeve të mësipërme të financimit, ministritë e linjës kryejnë projekte kapitale në komuna, projekte këto që bien në kompetencat e qeverisjes lokale. Buxheti i përgjithshëm për investime të tilla nga viti 2018 deri në vitin 2020 arriti në 263.84 milionë €. Nga kjo shumë, investime reale ishin 192.53 milionë €, ose 73% e buxhetit (shih figurën më poshtë). Mesatarisht, 64.17 milionë € u investuan çdo vit. Ato ishin më të larta në krahasim me periudhën e mëparshme midis viteve 2011 dhe 2017 kur arritën në 44.47 € mesatarisht.


Për sa i përket numrit të projekteve kapitale, rreth 700 projekte individuale janë financuar në periudhën 2018-2020 krahasuar me 930 projekte të financuara në periudhën 2011-2017.

Figura 1. Gjithsej investime kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale për periudhën 2018-2020




Për periudhën 2018-2020, shuma e përgjithshme prej 192.53 milionë € është investuar nga 10 ministri të linjës. Këto investime përbëjnë 12.73% të buxhetit të tyre të përgjithshëm kapital. Ndërsa në periudhën 2011-2017, 12 ministri të linjës kishin investuar një përqindje të ngjashme të buxhetit të tyre kapital brenda kompetencave komunale.

Figura 2. Investime kapitale nga 10 ministritë e linjës në kompetencat komunale për periudhën 2018-2020



Investimet në kompetenca komunale janë siguruar krahas investimeve të rregullta të financuara përmes një granti të përgjithshëm për komunitet që për periudhën 2018-2020 arritën në 464.35 milionë €. Kështu, investimet e kombinuara në komuna nga këto dy burime ishin 656.89 milionë €.

Figura 3. Investimet kapitale në kompetencat komunale dhe IK nga Granti i Përgjithshëm për periudhën 2018 -2021



Gjatë periudhës 2018-2020, këto investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale përbënin 2.7% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës (Shih tabelën 2). Në vitin 2020, këto investime ishin dukshëm më të ulëta se në dy vitet e mëparshme kryesisht për shkak të

shfaqjes së pandemisë, kështu që kishin pjesëmarrje shumë më të ulët në buxhetin e përgjithshëm. Ndërsa në periudhën 2011-2017, këto investime përbënin 2.8% të buxhetit të Kosovës.

Këto investime shtesë nga ministritë e linjës kishin një vlerë të konsiderueshme për komunitetet përfituese. Pra, për periudhën 2018 - 2020, ato arritën 41% të buxhetit të tyre për shpenzimet kapitale. Në dy vitet e para, ishin edhe më të larta në përqindje. Por, në vitin 2020, ato ranë në 29% të buxhetit kapital komunal nga 52% në vitin 2019. Ndërsa në periudhën 2011-2017, këto investime shtesë kishin një kontribut edhe më të lartë, duke përbërë 62% të buxhetit komunal për investime kapitale.

Tabela 1: Investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale (2011-2017 dhe 2018 - 2020)					
Viti	IK nga ministritë në KK Në 000 €	IK në KK si % e buxhetit të Kosovës		IK në KK si % e IK në grantin e përgjithshëm për komunitetet	
		Buxheti i Kosovës në € 000	Në %	IK në Grantin e Përgjithshëm Në 000 €	Në %
2011	40,804	1,400,462	2.9%	86,163	47%
2012	35,636	1,466,457	2.4%	78,223	46%
2013	43,445	1,500,176	2.9%	84,159	52%
2014	51,039	1,498,399	3.4%	90,214	57%
2015	44,832	1,315,184	3.4%	57,825	78%
2016	43,201	1,750,675	2.5%	60,579	71%
2017	52,417	2,001,020	2.6%	67,021	78%
<b>Sub Total</b>	<b>311,374</b>	<b>10,932,373</b>	<b>2.8%</b>	<b>524,184</b>	<b>62.7%</b>
2018	61,337	2,080,481	2.9%	146,115	42.0%
2019	86,412	2,378,232	3.6%	164,918	52.4%
2020	44,784	2,620,369	1.7%	153,325	29.2%
<b>Sub Totali</b>	<b>192,533</b>	<b>7,079,081</b>	<b>2.7%</b>	<b>464,358</b>	<b>41.5%</b>

Siç tregohet në Tabelën 2, investimet në kompetencat komunale për vitet 2018-2020 arritën në 79% të të hyrave vetanake (THV) dhe ishin 2.6 herë më të larta se tatimi në pronë i mbledhur gjatë të njëjtës periudhë raportuese. Ndërsa gjatë periudhës 2011-2017, ato ishin 75% të THV-ve komunale dhe 2.3 herë më të larta se tatimi në pronë i mbledhur.

**Tabela 2: Investimet kapitale (IK) nga ministritë e linjës në kompetencat komunale në krahasim me të hyrat e përgjithshme vetanake (THV) komunale dhe tatimi në pronë (2018 - 2020)**

Viti	IK nga ministritë në kompetencat komunale	IK në kompetencat komunale si % e THV-ve komunale		IK në kompetencat komunale si % e tatimit në pronë	
		THV €000	%	Tatimi në pronë €000	%
2011	40,804	49,762	82%	14,364	284%
2012	35,636	59,538	60%	14,584	244%
2013	43,445	55,798	78%	16,119	269%
2014	51,039	60,698	84%	20,411	250%
2015	44,832	57,887	77%	19,796	226%
2016	43,201	69,849	62%	25,123	172%
2017	52,417	64,276	82%	22,407	233%
<b>Sub Total</b>	<b>311,374</b>	<b>417,808</b>	<b>75%</b>	<b>132,804</b>	<b>234%</b>
2018	61,337	80,497	76%	24,196	254%
2019	86,412	88,718	97%	27,277	317%
2020	44,784	74,591	60%	22 704	197%
<b>Totali</b>	<b>192,533</b>	<b>243,806</b>	<b>79%</b>	<b>74,176</b>	<b>260%</b>

## 2.1. Investitorët më të mëdhenj në kompetencat komunale

Dhjetë (10) ministri të linjës kanë financuar projekte kapitale në kompetencat komunale gjatë tri viteve midis periudhës 2018-2020. Investitorët më të mëdhenj ishin Ministria e Infrastrukturës (MI) me 89 milionë €, që përbëjnë 46.7% të vlerës totale të investuar. Pasohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me 15.5% dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) me 14.8% të totalit (shih tabelë 3). Të njëjtat ministri kishin qenë investitorët më të mëdhenj në periudhën 2011-2017. Pastaj, MI-ja kishte investuar 47.6%, MASHT-i 22.5% dhe MKRS-ja 9% të totalit (shih tabelën 4).

Tabela 3: Investitorët më të mëdhenj në kompetencat komunale për periudhën 2018-2020<sup>1</sup>

Ministria Në €000		Buxheti i alokuar		Shpenzimet		Shpenzimet për vit mesa- tarisht
		Në %	Në €000	Në %	Në €000	
1	Ministria e Infrastrukturës	105,548	41.1%	89,851	46.7%	29,950
2	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	35,878	14.0%	29,934	15.5%	9,978
3	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	45,544	17.7%	28,554	14.8%	9,518
4	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	29,939	11.7%	20,528	10.7%	6,843
5	Ministria e Administratës Publike	6,754	2.6%	6,591	3.4%	2,197
6	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	18,706	7.3%	6,494	3.4%	2,165
7	Ministria e Shëndetësisë	8,401	3.3%	5,339	2.8%	1,780
8	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	4,029	1.6%	3,754	1.9%	1,251
9	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1,740	0.7%	1,320	0.7%	440
10	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	205	0.1%	168	0.1%	56
TOTALI		256,745	100.0%	192,533	100.0%	64,178

Table 4: Investitorët më të mëdhenj në kompetencat komunale për periudhën 2011-2017

Ministria €000		Buxheti i alokuar		Shpenzimet		Shpenzimet për vit mesa- tarisht
		%	€000	%	€000	
1	Infrastruktura	196,462	48.6%	148,434	47.6%	21,205
2	Arsimi, Shkenca dhe Teknologjia	81,863	20.0%	70,090	22.5%	10,013
3	Kultura, Rinia dhe Sporti	44,007	10.7%	28,198	9.0%	4,028
4	Administrimi i Pushtetit Lokal	28,806	7.0%	19,922	6.4%	2,846
5	Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor	28,179	6.9%	17,586	5.6%	2,512

<sup>1</sup> Ministria për Zhvillimin Lokal gjithashtu ka investuar 5.41 milionë brenda komunave për periudhën trevjeçare midis 2018 dhe 2020. Megjithatë, vetëm shumat totale të këtyre investimeve janë raportuar në bazën e të dhënave të thesarit nën linjën e vetme të quajtur "Programi i Zhvillimit Rajonal" pa dhënë detaje për projektet individuale të financuara. Për shkak të mungesës së përshkrimit të projektit, ne nuk mund të përcaktonim nëse ato investime bien brenda kompetencave të qeverisë qendrore apo komunale.

Për më tepër, MI-ja ka shfrytëzuar 15.8% të gjithsej buxhetit të saj kapital të alokuar për investime kapitale në komuna. Në periudhën 2011-2017, ajo kishte përdorur vetëm 9% të buxhetit të saj kapital.

MASHT-i ka përdorur 41% krahasuar me 43.2% të shpenzuar në periudhën 2011-2017. Ndërsa MKRS-ja ka shpenzuar 38.9% të buxhetit të alokuar krahasuar me 48.7% të përdorur në periudhën 2011-2017 (shih tabelat 5 dhe 6).

**Table 5: Investments in municipal competencies as a % of budget per CI for 2018-2020**

Ministry		Total budget for CI	CI in municipal competencies	As a % of budget for CI
€000		€000	In %	
1	MI	568,241	89,851	15.8%
2	MASHT	72,957	29,934	41.0%
3	MKRS	73,359	28,554	38.9%
4	MMPH	87,547	20,528	23.4%
5	MPA	27,972	6,591	23.6%

**Table 6: Investments in municipal competencies as a % of budget per CI for 2011-2017**

Ministry		Total budget for CI	CI in municipal competencies	As a % of budget for CI
€000		€000	In %	
1	MI	1,621,782	148,433	9.1%
2	MASHT	161,889	70,089	43.3%
3	MKRS	57,916	28,198	48.7%
4	MAPL	28,242	19,921	70.5%
5	MESP	225,842	17,585	7.8%

## 2.2. Përfituesit më të mëdhenj të investimeve kapitale në kompetencat komunale

Janë 35 komuna nga 38 në total që kanë marrë investime shtesë nga ministritë e linjës. Vetëm komunat e Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut dhe Mamushës nuk kanë marrë fare investime të tilla. Megjithatë, shumat e investuara ndryshuan midis komunave përfituese.

Sa i përket vlerës totale të investuar, përfituesit më të mëdhenj ishin komuna e Gjakovës e cila mori 22 milionë € ose 11.5% të totalit. Pasohet nga komuna e Ferizajt me 20 milionë € ose 10.4%, dhe komuna e Pejës me 13.8 milionë € ose 7.2% të totalit (shih tabelën 7).

Gjatë periudhës së mëparshme 2011-2017, shumat më të mëdha ishin investuar në komunën e Skenderajt që kishte marrë 43.4 milionë € ose 13.9% të totalit të investuar. Ajo ishte ndjekur nga Prishtina me 21.7 milionë € (6.9%), dhe Peja me 20.8 milionë € (6.7%) (shih tabelën 8).

Tabela 7: Përfituesit më të mëdhenj të investimeve në kompetencat komunale për periudhën 2018-2020				
Komuna €000		Vlera totale e IK të pranuar		IK të pranuar mesatarisht për vit
		% e totalit	€000	
1	Gjakova	22,058	11.5%	7,353
2	Ferizaj	20,073	10.4%	6,691
3	Peja	3,870	7.2%	4,623
4	Deçan	13,785	7.2%	4,595
5	Prishtina	13,385	7.0%	4,462
6	Mitrovica	11,090	5.8%	3,697
7	Prizren	8,846	4.6%	2,949

Tabela 8: Përfituesit më të mëdhenj të investimeve në kompetencat komunale për periudhën 2011-2017				
Komuna €000		Vlera totale e IK të pranuar		IK të pranuar mesatarisht për vit
		% Of total	€000	
1	Skenderaj	43,352	13.9%	6,193
2	Prishtina	21,727	6.9%	3,104
3	Peja	20,864	6.7%	2,981
4	Gjilan	15,941	5.1%	2,277
5	Ferizaj	15,279	4.9%	2,183
6	Podujeva	15,274	4.9%	2,182
7	Prizren	14,002	4.5%	2,000

Sa i përket shumave të pranuar për kokë banori, përfituesit më të mëdhenj për periudhën 2018-2020 ishin komuna e Junikut që mori 428 €, Deçani 344 €, dhe e treta ishte komuna e Gjakovës me 233 € për kokë banori. Kur shikojmë mesataren vjetore, Juniku ka marrë 143 €, Deçani 115 € dhe Gjakova 78 € për kokë banori (shih tabelën 9)

Ndërsa gjatë periudhës shtatëvjeçare të mëparshme 2011-2017, përfituesit më të mëdhenj sa i përket mesatares vjetore për kokë banori ishin komuna e Skenderajt që kishte marrë 118 €, e Shtimes 55 €, dhe e Hanit të Elezit me 52 € mesatare vjetore për kokë banori (shih tabelën 10).

**Tabela 9: Përfituesit më të mëdhenj të investimeve në kompetencat komunale për periudhën 2018-20 (për kokë banori)<sup>2</sup>**

Komuna		Popullsia €000	Totali i IK për kokë banori	IK për kokë banori për vit mesatarisht
			€000€	
1	Junik	6,084	2,603	428
2	Deçan	40,019	13,785	344
3	Gjakova	94,556	22,058	233
4	Ferizaj	108,610	20,073	185
5	Skenderaj	7,481	8,475	183
6	Mitrovica	50,858	11,090	167
7	H. Elezit	71,909	1,401	154

**Tabela 10: Përfituesit më të mëdhenj të investimeve në kompetencat komunale për periudhën 2018-20 (për kokë banori)<sup>3</sup>**

Komuna		Popullsia €000	Totali i IK për kokë banori	IK për kokë banori për vit mesatarisht
			€000€	
1	Skenderaj	52,711	52,711	822
2	Shtime	27,864	27,864	385
3	H. Elezit	10,009	10,009	364
4	Junik	6,482	6,482	341
5	Istog	40,271	40,271	285
6	Kaçanik	34,312	34,312	272
7	Kllokot	2,741	2,741	247

<sup>2</sup> Numrat e popullsisë sipas Agjencisë Kosovare për Statistikat Vlerësimi 2020

<sup>3</sup> Numrat e popullsisë sipas Agjencisë Kosovare për Statistikat Vlerësimi 2020

Për periudhën 2018-2020, investimet në kompetencat komunale ishin konsiderueshëm në përpjesëtim me buxhetin komunal për investime kapitale. Ndër 13 përfituesit më të mëdhenj komunal, kontributi i tyre sillej ndërmjet 197.6% në komunën e Deçanit dhe 12% në Prizren. Mesatarisht, investimet kapitale nga ministritë e linjës në ato komuna arritën 54.5% të buxheteve të tyre vjetore për investime kapitale (shih tabelën 11). Ndërsa gjatë periudhës 2011-2017, 13 përfituesit më të mëdhenj kishin marrë sa 26.47% të buxheteve të tyre për investime kapitale (shih tabelën 12).

**Tabela 11: Investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale si % e buxhetit të përgjithshëm komunal dhe buxhetit për investime kapitale (IK) për periudhën 2018-2020**

Komuna Në € 000		Buxheti i përgjithshëm për 3 vitet	Buxheti për IK për 3 vitet	IK nga ministritë e linjës për 3 vitet	IK si % e buxhetit të përgjithshëm	IK si % e buxhetit për IK
		Në € 000	Në € 000	Në %	Në %	
1	Gjakova	75,384	28,195	22,058	29.3%	78.2%
2	Ferizaj	93,701	37,681	20,073	21.4%	53.3%
3	Peja	80,009	30,931	13,870	17.3%	44.8%
4	Deçani	27,227	6,977	13,785	50.6%	197.6%
5	Prishtina	251,746	110,024	13,385	5.3%	12.2%
6	Mitrovica	60,328	16,626	11,090	18.4%	66.7%
7	Prizreni	143,705	73,447	8,846	6.2%	12.0%

**Tabela 12: Investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale si % e buxhetit të përgjithshëm komunal dhe buxhetit për investime kapitale (IK) për periudhën 2011-2017**

Komuna Në € 000		Buxheti i përgjithshëm për 3 vitet	Buxheti për IK për 3 vitet	IK nga ministritë e linjës për 3 vitet	IK si % e buxhetit të përgjithshëm	IK si % e buxhetit për IK
		Në € 000	Në € 000	Në %	Në %	
1	Skenderaj	79,792	23,674	43,352	54.3%	183.1%
2	Prishtina	553,864	287,171	21,727	3.9%	7.6%
3	Peja	148,720	42,252	20,864	14.0%	49.4%
4	Gjilan	151,675	31,635	15,941	10.5%	50.4%
5	Ferizaj	172,348	62,178	15,279	8.9%	24.6%
6	Podujeva	126,764	41,725	15,274	12.0%	36.6%
7	Prizren	240,267	137,597	14,002	5.8%	10.2%

Siç tregohet në tabelat më sipër dhe në analizën e detajuar të bashkangjitur si shtojcë, gjatë periudhës 2018-2020 si dhe për 2011-2017, disa komuna kanë marrë më shumë investime sesa të tjerat, edhe pasi të rregullohen për madhësinë e komunës, popullsinë, nivelin e zhvillimit ekonomik dhe karakteristikat e tjera.



### 3. Proceset vendimmarrëse të ministrive të linjës për investimet kapitale në kompetencat komunale

Kompetencat e nivelit të qeverisjes qendrore dhe asaj lokale janë përcaktuar në disa ligje, përfshirë Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe legjislacionin që është specifik për sektor<sup>4</sup>. Sidoqoftë, ato nuk janë përcaktuar qartë në të gjitha rrethanat e mundshme.

Për më tepër, nuk ka rregulla zyrtare që lidhen me investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale. E bën të vështirë përcaktimin nëse investime të caktuara u përkasin kompetencave të qeverisë qendrore apo kompetencave komunale. Megjithatë, ministritë e linjës kanë vazhduar zbatimin e projekteve të tilla dhe vlera e investimeve është rritur me kalimin e viteve.

Në vitin 2018 ne patëm shqyrtuar investime të tilla të kryera për periudhën midis viteve 2011 dhe 2017. Gjetja jonë kryesore ishte se ministrive financuese u kishin munguar kriteret dhe proceset zyrtare për përzgjedhjen e projekteve dhe zbatimin e tyre. Kjo kishte krijuar rrezik për shpërndarje të njëanshme dhe të pabarabartë të fondeve. Si pasojë, disa komuna kishin marrë vlerë shumë më të lartë pa ndonjë dëshmi mbështetëse. Pas atij studimi, Ministria e Financave kishte përfshirë një paragraf në ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2019 që kërkonte nga ministritë e linjës të krijonin rregulloret e brendshme për shpenzimin e investimeve të tyre kapitale në kompetencat komunale. Kjo u përsërit edhe në ligjin e buxhetit për vitin 2020.

Pra, për të ndjekur zbatimin e kësaj kërkesë buxhetore, ne kemi kryer një studim të ri të investimeve në kompetencat komunale që mbulon tri vitet midis periudhës 2018-2020. Si pjesë e këtij studimi kemi zhvilluar një takim me departamentin e buxhetit të MF -së me qëllim që të kuptojmë zbatimin e asaj dispozite të re të ligjeve të buxhetit nga ministritë e linjës. Sipas zyrtarit të intervistuar, nuk ka dëshmi se ministritë e linjës, përveç MAPL -së, kanë zhvilluar procedura të shkruara për investime në komuna siç kërkohet nga ligjet e buxhetit.

Për ta konfirmuar këtë nga burimi, ne kemi kërkuar takime në pesë ministritë që ishin investitorët më të mëdhenj në komuna. Sidoqoftë, vetëm MAPL-ja e ka pranuar kërkesën tonë për takim. Kështu, ne kemi konfirmuar se ka zhvilluar procesin dhe kriteret zyrtare për financimin e investimeve kapitale në komuna. Megjithëse Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit nuk iu përgjigj kërkesës sonë për takim, ne ishim në gjendje që, nga analizimi i të dhënave dytësore, të konstatojmë se edhe ajo ka zhvilluar procesin zyrtar të investimit dhe kriteret e kërkuara. Nënseksionet e mëposhtme përshkruajnë shkurtimisht procesin dhe kriteret e përdorura nga MAPL-ja dhe MMPH-ja për investimin e projekteve kapitale në komuna.

<sup>4</sup> Legjislacioni specifik për arsim, shëndetësi, mjedis, kulturë, infrastrukturë publike, etj.

### **3.1. Investimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në komuna.**

MAPL-ja ka disa projekte të fokusuara në zhvillimin komunal. Njëra prej tyre është skema e Grantit të Performancës Komunale e menaxhuar bashkërisht me DEMOS-in (zvicëran, suedez dhe norvegjez), e cila jep grante kapitale për komunat me performancë të mirë. Ajo gjithashtu udhëheq projekte të tjera socio-ekonomike, si dhe projektin e ndërmarrësisë së të rinjve me Bankën Botërore, etj. Gjatë takimit me zyrtarët e MAPL-së përgjegjës për investimet në komuna, ne ishim në gjendje të konfirmim që MAPL-ja ka zhvilluar kritere investimi siç kërkohet nga ligjet e buxhetit të viteve 2019 dhe 2020. Këto kritere janë përditësuar çdo vit dhe gjithashtu janë miratuar nga qeveria siç kërkohet nga ligji i buxhetit i vitit 2020. Prandaj, ajo financon projektet kapitale që kontribuojnë në zhvillimin e infrastrukturës socio-ekonomike në komuna. Ekzistojnë pesë kritere të pranueshmërisë. Komunat janë të detyruara të përmbushin të paktën tri prej tyre për të qenë në gjendje të aplikojnë për fondet komunale. Ministria siguron deri në 50,000 € për projekt.

#### ***Kush i përgatit, vlerëson dhe jep projektet?***

MAPL-ja ka një proces të vendosur zyrtarisht për investime në komuna. Fillon me njoftimin publik ku të gjitha komunat e interesuara janë të ftuara të paraqesin projekt propozimet që do të financohen ose bashkëfinancohen nga ministria. Pas marrjes së aplikacioneve komunale që vijnë në formatin standard, Ministri krijon një komision që vlerëson propozimet komunale dhe rekomandon projekte të veçanta që do të financohen nga ministria. Bazuar në rekomandimin e komisionit, Ministri miraton listën e projekteve që do të financohen nga ministria. Më pas, nënshkruhet një marrëveshje si “memorandum mirëkuptimi” midis ministrisë dhe komunave përfituese duke sqaruar rolet dhe përgjegjësitë e të dyja palëve në lidhje me zbatimin e projekteve të caktuara.

#### ***Kush i menaxhon procedurat e prokurimit?***

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, komunat përfituese kryejnë procedurat e prokurimit për zbatimin e projektit. Pas procedurave të tenderimit dhe përzgjedhjes së ofertuesit më të mirë, komunat përfituese nënshkruajnë kontratën e prokurimit për zbatimin e projektit.

#### ***Kush e menaxhon kontratën?***

Komunat përfituese janë gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e kontratës për sa i përket emërimit të menaxherit të kontratës, mbikëqyrësit dhe komisionit për pranimin e punës. Procesi i menaxhimit të kontratës është i njëjtë si për të gjitha projektet e tjera kapitale të udhëhequra nga komunat në përputhje me ligjin dhe rregulloret e prokurimit.

#### ***Kush e monitoron ekzekutimin e projekteve?***

Procesi i zbatimit të kontratës i kryer nga komunat përfituese monitorohet rregullisht nga MAPL-ja. Ministria e bën këtë duke emëruar një komision monitorues specifik që mbikëqyr projektet në terren nëse sasia dhe cilësia e punëve të kryera janë sipas kontratës dhe specifikimeve të projektit.

### ***Kush i pranon produktet e projektit?***

Produktet e projektit të arritura në piketa të caktuara si dhe produktet përfundimtare të projektit në formën e investimeve kapitale ose asetëve pranohen si nga komunat përfituese ashtu edhe nga MAPL-ja. Megjithatë, ato e bëjnë atë në mënyrë të pavarur nga njëra -tjetra dhe vetëm produktet e projektit të pranuar nga komisioni i MAPL -së paguhen nga Ministria.

### ***Kush i ekzekuton pagesat?***

Ministria paguan faturat e kontraktorit bazuar në dokumentacionin e nënshkruar nga komisioni i MAPL-së që vërteton se puna e marrë përsipër është kryer në përputhje të plotë me kontratën. Për këtë qëllim, fatura/-t dhe i gjithë dokumentacioni mbështetës i dërgohen departamentit të financave të MAPL -së ku kontrollohen nga zyrtari verifikues. Nëse fatura/-t janë në përputhje me kontratën, pagesa verifikohet dhe fondet i disbursohen kontraktorit përkatës.

## **3.2. Investimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit në komuna.**

Megjithëse MEA-ja nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për takim, ne ishim në gjendje të konfirmim se edhe ajo ka zhvilluar procesin dhe kriteret zyrtare për investimet kapitale në komuna. Së bashku me GIZ-in, ajo udhëheq një skemë të veçantë të granteve të performancës komunale për një mjedis të pastër. Prandaj, ministria jep grante kapitale për komunat bazuar në performancën e tyre me shërbimet e menaxhimit të mbeturinave. Granti i shpërblyer është caktuar për blerjen e pajisjeve dhe makinerive të lidhura me menaxhimin e mbeturinave. Komunat përfituese përzgjidhen dhe përfitojnë grante në bazë të rregullave specifike që ministria i ka zhvilluar në bashkëpunim me MAPL-në. Rregullat përcaktojnë kushtet minimale që komunat duhet t'i plotësojnë për t'u kualifikuar për grant, dhe treguesit e përdorur për matjen e performancës komunale në lidhje me mjedisin e pastër. Gjithashtu përcakton parimet për alokimin e grantit, vlerësimin e performancës, dhe procesin e vendimmarrjes. Krahas rregullave të përgjithshme, ministria ka zhvilluar një dokument tjetër të quajtur udhëzime teknike për zbatimin e granteve komunale për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave. Ai ofron detaje të mëtejshme në lidhje me procedurat që duhet ndjekur për zbatimin e grantit të performancës duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes, metodologjinë e dhënies si dhe procesin e monitorimit dhe raportimit.

Sipas dokumentacionit të sipërpërmendur, komunat që përfitojnë grante planifikojnë projekte kapitale, për t'u financuar nga granti i ministrisë, si pjesë e procesit të tyre buxhetor vjetor. Ato kryejnë procesin e prokurimit për zbatimin e projektit kapital dhe nënshkruajnë kontratën. Për shkak të kapaciteteve të limituar të komunave përfituese, procesi i prokurimit është duke u kryer përkohësisht nga MEA-ja në emër të komunave.



## 4. Përfundimet

Gjatë tri viteve midis periudhës 2018-2020, 10 ministri të linjës kanë investuar mesatarisht 192.53 milionë € ose 64.17 milionë € në vit në fushat që bien në kompetencat komunale. Vlera e investimeve të tilla është rritur në krahasim me periudhën shtatëvjeçare të studiuar më parë midis viteve 2011 dhe 2017 kur 13 ministri të linjës kishin investuar mesatarisht 44.47 € në vit.

35 komuna kanë përfituar nga këto investime megjithëse shumat e investuara ndryshonin ndjeshëm. Komunat e Gjakovës, Ferizajt dhe Pejës kanë marrë shumat më të mëdha. Ndërsa Juniku, Deçani dhe Gjakova kanë marrë shumat më të mëdha të investimeve për kokë banori.

Ligjet e buxhetit për vitet 2019 dhe 2020 vënë një detyrim ligjor mbi ministrinë e linjës për të aplikuar kritere specifike, të qarta, të drejta dhe transparente për financimin ose bashkëfinancimin e projekteve në komuna. Këto kritere duhet të miratohen paraprakisht nga qeveria qendrore dhe duhet të marrin parasysh zhvillimin e balancuar komunal dhe ndërkomunal në ndërtimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve. Për më tepër, ministrive të linjës iu kërkua të nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi me komunat përfituese, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e të dyja palëve në lidhje me procesin e zbatimit të projektit.

MAPL-ja dhe MEA-ja kanë aplikuar kritere specifike dhe transparente për investime në komuna. Vetëm MAPL-ja i kishte të aprovuara paraprakisht nga qeveria, siç kërkohet nga ligji i buxhetit për vitin 2020. Sidoqoftë, të dy këto ministri kanë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me komunat përfituese dhe kanë investuar në një mënyrë më të ekuilibruar në kuptim të investimeve të ndryshme në mbështetje të komunave më pak të zhvilluara.

Kur bëhet fjalë për tetë ministrinë tjera, nuk ka dëshmi se ato kanë zhvilluar kritere të shkruara për investime sipas kërkesave të ligjit të buxhetit. Kështu, ka të ngjarë që ato të kenë vazhduar investimet në kompetencat komunale duke ndjekur procese jozyrtare të vendimmarrjes. Një praktikë e tillë mund të çojë në një shpërndarje të pabarabartë të fondeve kapitale dhe kështu të dështojnë për të siguruar një zhvillim të balancuar të infrastrukturës kapitale në mesin e komunave. Kjo gjithashtu rrit rrezikun për vendime të njëanshme që favorizojnë disa komuna më shumë se të tjerat.

Në përgjithësi, mungesa e kritereve zyrtare të investimeve mund të çojë në një përfundim se investimet në komuna janë ndikuar nga konsideratat politike. Procesi do të vazhdojë të shihet si i njëanshëm dhe i pabarabartë për sa kohë që investimet bëhen në mungesë të ndonjë procedure zyrtare. Prandaj, ministrinë e linjës duhet të adresojnë me urgjencë këtë çështje të pazgjidhur.



## 5. Rekomandimet

Ky seksion përmban rekomandime si për Ministrinë e Financave si sponsori kryesor i ligjit vjetor të buxhetit, ashtu edhe për ministritë e linjës që kanë dështuar në zhvillimin e kriterëve për investime në komuna. Disa nga rekomandimet nga studimi ynë i mëparshëm nuk janë adresuar. Ne e konsiderojmë zbatimin e tyre të nevojshëm për të siguruar investime të paanshme dhe efektive. Prandaj i kemi përsëritur disa prej tyre në këtë pjesë të raportit.

- 1.** Ministria e Financave duhet të sigurojë që ligji i buxhetit për vitin 2022 e në vazhdim të përfshijë një dispozitë të ngjashme me atë të përdorur në ligjin e buxhetit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 që kërkonte nga ministritë e linjës të zhvillonin procedurat dhe kriteret zyrtare për investimin e projekteve kapitale në komuna. Ajo gjithashtu duhet të kërkojë një shpërndarje më të barabartë të fondeve në mbështetje të rajoneve dhe komunave më pak të zhvilluara. Për fund, e njëjta dispozitë duhet të vendosë ndëshkimin për ato ministri të linjës që vazhdojnë të investojnë në mungesë të procesit dhe kriterëve të përzgjedhjes të kërkuara. Ndëshkimi mund të marrë formën e pezullimit të një shume të caktuar të alokimit të buxhetit derisa procesi të jetë vendosur si duhet.
- 2.** Ministritë e linjës që kryejnë investime kapitale në komuna duhet të zhvillojnë politika për investime të tilla. Ato duhet t'i përshkruajnë objektivat kryesorë të ndjekur si dhe fushat prioritare për investimet. Politikat e tilla duhet të shërbejnë si një udhëzues i përgjithshëm për përzgjedhjen e projekteve të veçanta për financim.
- 3.** Bazuar në ligjin për buxhetin dhe politikat e investimeve, ministritë e linjës duhet të zhvillojnë procedura dhe kriterë të shkruara për investimet në komuna. Kriteret duhet të jenë specifike dhe të matshme për të mundësuar përzgjedhjen e projekteve më të përshtatshme që do të përmbushin më së miri objektivat e ndjekur të politikave. Së paku duhet të përfshijnë:
  - a. Kushtet, dhe kërkesat e përshtatshmërisë për financimin e projekteve kapitale në kompetencat komunale.
  - b. Një proces të hapur publik për investimet kapitale duke ofruar kështu qasje transparente dhe të barabartë në mundësitë e financimit për të gjitha komunat.
  - c. Kriterë specifike dhe të matshme për vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve komunale për mbështetje financiare.
  - d. Një procedurë që është e bazuar në rregulla, e drejtë dhe transparente e vlerësimit të projektit, e cila siguron përzgjedhjen dhe financimin meritore të projekteve.
  - e. Një proces të qartë dhe përgjegjësi të qarta për udhëheqjen e prokurimit, menaxhimit dhe monitorimit të investimeve në kompetencat komunale.
- 4.** Në planin afatgjatë, aspektet financiare dhe administrative të investimeve kapitale nga ministritë e linjës brenda kompetencave komunale duhet të adresohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe/ose Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Duhet të shtohet një dispozitë e veçantë që kërkon nga të gjitha ministritë që të zhvillojnë Udhëzime Administrative që përshkruajnë proceset për kërkesën, përzgjedhjen dhe ekzekutimin e projekteve të investimeve kapitale që bien brenda

përgjegjësisë financiare të komunës. Dispozita duhet të përfshijë gjithashtu kërkesa të përgjithshme dhe kriteret minimale të përzgjedhjes për investimet brenda kompetencave komunale. Ndërsa aspektet shtesë të këtyre investimeve mund të rregullohen nga legjislacioni specifik për zhvillimin rajonal.

## Shtojca I - Investimet kapitale nga ministritë sipas komunave

Capital Investments from Ministries in Municipal competencies 2018 -2020								
YEAR	2018		2019		2020		Total	
MUNICIPALITY	€	%	€	%	€	%	€	%
GJAKOVË	2,828,011	4.6%	13,279,919	15.4%	5,950,244	13.3%	22,058,174	11.5%
FERIZAJ	5,172,317	8.4%	11,167,697	12.9%	3,732,651	8.3%	20,072,666	10.4%
PEJË	7,358,160	12.0%	4,771,856	5.5%	1,739,951	3.9%	13,869,967	7.2%
DEÇAN	3,150,555	5.1%	6,116,976	7.1%	4,517,822	10.1%	13,785,354	7.2%
PRISHTINË	6,147,027	10.0%	5,204,600	6.0%	2,033,584	4.5%	13,385,211	7.0%
MITROVICË	3,343,421	5.5%	4,297,381	5.0%	3,448,994	7.7%	11,089,796	5.8%
PRIZREN	4,028,793	6.6%	2,503,695	2.9%	2,313,484	5.2%	8,845,972	4.6%
GJILAN	2,805,592	4.6%	2,962,176	3.4%	3,075,624	6.9%	8,843,392	4.6%
SKENDERAJ	3,500,190	5.7%	3,281,787	3.8%	1,693,492	3.8%	8,475,469	4.4%
SUHAREKË	1,867,987	3.0%	1,869,346	2.2%	1,501,724	3.4%	5,239,057	2.7%
LIPJAN	1,858,299	3.0%	1,929,755	2.2%	890,941	2.0%	4,678,995	2.4%
KAÇANIK	1,719,862	2.8%	1,636,486	1.9%	1,258,976	2.8%	4,615,324	2.4%
RAHOVEC	1,666,535	2.7%	1,965,181	2.3%	784,736	1.8%	4,416,452	2.3%
KLINË	1,490,010	2.4%	2,003,649	2.3%	863,714	1.9%	4,357,373	2.3%
MALISHEVË	492,534	0.8%	2,510,887	2.9%	1,340,994	3.0%	4,344,415	2.3%
KAMENICË	767,747	1.3%	1,933,069	2.2%	1,477,278	3.3%	4,178,093	2.2%
PODUJEVË	1,335,585	2.2%	1,958,672	2.3%	810,511	1.8%	4,104,768	2.1%
GLLOGOC	1,478,304	2.4%	1,981,551	2.3%	562,297	1.3%	4,022,152	2.1%
VITI	1,443,937	2.4%	1,457,020	1.7%	749,831	1.7%	3,650,788	1.9%
ISTOG	971,947	1.6%	1,216,019	1.4%	1,261,667	2.8%	3,449,632	1.8%
OBILIQ	753,894	1.2%	2,206,131	2.6%	226,433	0.5%	3,186,458	1.7%
JUNIK	626,631	1.0%	1,207,070	1.4%	768,955	1.7%	2,602,656	1.4%
VUSHTRRI	705,085	1.1%	617,190	0.7%	1,216,008	2.7%	2,538,283	1.3%
SHTIME	1,117,755	1.8%	1,002,057	1.2%	218,028	0.5%	2,337,840	1.2%
DRAGASH	548,720	0.9%	712,173	0.8%	209,343	0.5%	1,470,237	0.8%
HANI I ELEZIT	122,464	0.2%	703,397	0.8%	575,187	1.3%	1,401,048	0.7%
ZVEÇAN	489,782	0.8%	863,180	1.0%	18,556	0.0%	1,371,518	0.7%
FUSHË KOSOVË	257,464	0.4%	776,473	0.9%	112,583	0.3%	1,146,520	0.6%
GRAÇANICË	433,540	0.7%	699,236	0.8%	6,202	0.0%	1,138,978	0.6%
SHTËRPECË	115,887	0.2%	186,363	0.2%	-	0.0%	302,250	0.2%
LEPOSAVIQ	-	0.0%	152,892	0.2%	-	0.0%	152,892	0.1%
RANILLUG	-	0.0%	121,912	0.1%	-	0.0%	121,912	0.1%
NOVO BËRD	86,750	0.1%	12,472	0.0%	-	0.0%	99,223	0.1%
PARTESH	-	0.0%	80,000	0.1%	-	0.0%	80,000	0.0%
KLLOKOT	-	0.0%	52,396	0.1%	-	0.0%	52,396	0.0%
MITROVICA VERIORE	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%
MAMUSHË	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%
Komuna	2,652,096	4.3%	2,971,668	3.4%	1,424,276	3.2%	7,048,040	3.7%
<b>Total</b>	<b>61,336,882</b>	<b>100.0%</b>	<b>86,412,334</b>	<b>100.0%</b>	<b>44,784,088</b>	<b>100.0%</b>	<b>192,533,303</b>	<b>100.0%</b>

## Shtojca II - Investimet kapitale nga ministritë për komunë për kokë banori

Annex II – Capital Investments by Ministries per Municipality per Capita						
No	Municipality	Per Capita in 2018 (€)	Per Capita in 2018 (€)	Per Capita in 2018 (€)	Total per Capita 2018 - 2020 (€)	Population 2020
1	JUNIK	103	198	126	428	6,084
2	DEÇAN	79	153	113	344	40,019
3	GJAKOVË	30	140	63	233	94,556
4	FERIZAJ	48	103	34	185	108,610
5	ZVEÇAN	65	115	2	183	7,481
6	SKENDERAJ	69	65	33	167	50,858
7	MITROVICË	46	60	48	154	71,909
8	HANI I ELEZIT	13	75	61	149	9,403
9	OBILIQ	35	102	11	148	21,549
10	PEJË	76	49	18	144	96,450
11	KAÇANIK	51	49	38	138	33,409
12	KAMENICË	21	54	41	116	36,085
13	KLINË	39	52	22	113	38,496
14	GRAÇANICË	41	66	1	107	10,675
15	GJILAN	31	33	34	98	90,178
16	ISTOG	25	31	32	88	39,289
17	SUHAREKË	31	31	25	88	59,722
18	SHTIME	41	37	8	86	27,324
19	LIPJAN	32	33	15	81	57,605
20	MALISHEVË	9	46	25	80	54,613
21	RAHOVEC	30	35	14	79	56,208
22	VITI	31	31	16	78	46,987
23	GLLOGOC	25	34	10	69	58,531
24	PRISHTINË	31	26	10	67	198,897
25	PRIZREN	23	14	13	50	177,781
26	PODUJEVË	15	22	9	46	88,499
27	PARTESH	-	45	-	45	1,787
28	SHTËRPCË	17	27	-	43	6,949
29	DRAGASH	16	21	6	43	33,997
30	VUSHTRRI	10	9	17	36	69,870
31	FUSHË KOSOVË	7	22	3	33	34,827
32	RANILLUG	-	32	-	32	3,866
33	KLLOKOT	-	20	-	20	2,556
34	NOVO BËRD	13	2	-	15	6,729
35	LEPOSAVIQ	-	11	-	11	13,773

## Shtojca III - Shpenzimet kapitale të ministrive në fushat e kompetencave komunale

Ministry Capital expenditure in Municipal Competenz areas								
MINISTRY	2018		2019		2020		Total 2018 - 2020	
	€	%	€	%	€	%	€	%
Infrastructure	25,752,580	42.0%	44,011,841	50.9%	20,086,843	44.9%	89,851,264	46.7%
Education, Science and Technology	7,659,843	12.5%	12,134,130	14.0%	10,139,957	22.6%	29,933,930	15.5%
Culture, Youth and Sport	11,724,087	19.1%	10,790,726	12.5%	6,039,403	13.5%	28,554,217	14.8%
Environment and Spatial Planning	9,799,974	16.0%	10,728,202	12.4%	0	0.0%	20,528,176	10.7%
Public Administration	3,246,775	5.3%	3,344,183	3.9%	0	0.0%	6,590,958	3.4%
Economy and Environment	0	0.0%	0	0.0%	6,493,952	14.5%	6,493,952	3.4%
Health	2,126,726	3.5%	2,685,730	3.1%	526,895	1.2%	5,339,351	2.8%
Ministry of Local Government Administration	385,182	0.6%	1,898,886	2.2%	1,469,703	3.3%	3,753,771	1.9%
Ministry of Labor and Social Welfare	544,593	0.9%	747,757	0.9%	27,335	0.1%	1,319,685	0.7%
Agriculture and Rural Development	97,127	0.2%	70,880	0.1%	0	0.0%	168,007	0.1%
<b>TOTAL</b>	<b>61,336,888</b>	<b>100.0%</b>	<b>86,412,336</b>	<b>100%</b>	<b>44,784,088</b>	<b>100.0%</b>	<b>192,533,312</b>	<b>100.0%</b>

Ministry Capital Expenditure in Municipal Competency Areas																
MINISTRY	2011		2012		2013		2014		2015		2016		2017		Total	
	ooo €	%	ooo €	%	ooo €	%	ooo €	%	ooo €	%	ooo €	%	ooo €	%	ooo €	%
Infrastructure	13,564	33.20%	11,728	32.90%	19,720	45.40%	30,255	59.30%	23,358	52.10%	21,491	49.70%	28,316	54.00%	148,434	47.70%
Education, Science and Technology	15,152	37.10%	13,615	38.20%	13,480	31.00%	12,531	24.60%	5,217	11.60%	5,178	12.00%	4,917	9.40%	70,090	22.50%
Culture, Youth and Sport	3,386	8.30%	3,824	10.70%	2,659	6.10%	2,907	5.70%	4,449	9.90%	3,297	7.60%	7,675	14.60%	28,198	9.10%
Government Administration	5,044	12.40%	3,407	9.60%	2,662	6.10%	641	1.30%	2,292	5.10%	2,922	6.80%	2,953	5.60%	19,922	6.40%
Environment and Spatial Planning	2,251	5.50%	1,418	4.00%	1,492	3.40%	2,164	4.20%	3,105	6.90%	2,510	5.80%	4,645	8.90%	17,586	5.60%
Economic Development	1,039	2.50%	1,006	2.80%	2,192	5.00%	1,466	2.90%	851	1.90%	5,247	12.10%	194	0.40%	11,996	3.90%
Public Administration	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	913	2.00%	1,452	3.40%	2,584	4.90%	4,950	1.60%
Health	368	0.90%	257	0.70%	634	1.50%	502	1.00%	2,022	4.50%	487	1.10%	429	0.80%	4,698	1.50%
Communities and Return	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	2,422	5.40%	199	0.50%	-	0.00%	2,621	0.80%
Labor and Social Welfare	-	0.00%	381	1.10%	427	1.00%	573	1.10%	201	0.40%	245	0.60%	421	0.80%	2,249	0.70%
Agriculture, Forestry and Rural Development	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	171	0.40%	282	0.50%	453	0.10%
Finance	-	0.00%	-	0.00%	179	0.40%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	179	0.10%
<b>TOTAL</b>	<b>40,804</b>	<b>100.00%</b>	<b>35,636</b>	<b>100.00%</b>	<b>43,445</b>	<b>100.00%</b>	<b>51,039</b>	<b>100.00%</b>	<b>44,832</b>	<b>100.00%</b>	<b>43,201</b>	<b>100.00%</b>	<b>52,417</b>	<b>100.00%</b>	<b>311,374</b>	<b>100.00%</b>

## Shtojca IV - Shpenzimet kapitale të ministrive të linjës në kompetencat komunale si % e buxhetit të tyre për investime kapitale

Line Ministries capital investments in municipal competencies as % of budget for capital investments									
MINISTRY	2018		2019		2020		Total 2018 - 2020		
	Allocated Budget for CI	CI in municipal competences	Allocated Budget for CI	CI in municipal competences	Allocated Budget for CI	CI in municipal competences	Allocated Budget for CI	CI in municipal competences	%
	000€	000€	000€	000€	000€	000€	000€	000€	
Infrastructure	300,370,575	25,752,580	288,854,447	44,011,841	141,361,545	20,086,843	730,586,567	89,851,264	12.3%
Education, Science and Technology	21,701,971	7,659,843	24,496,061	12,134,130	19,531,000	10,139,957	65,729,032	29,933,930	45.5%
Culture, Youth and Sport	14,373,704	11,724,087	21,724,309	10,790,726	17,478,278	6,039,403	53,576,290	28,554,217	53.3%
Environment and Spatial Planning	39,944,961	9,799,974	55,530,205	10,728,202	0	0	95,475,166	20,528,176	21.5%
Public Administration	10,270,072	3,246,775	15,864,894	3,344,183	0	0	26,134,966	6,590,958	25.2%
Economy and Environment	0	0	0	0	68,724,574	6,493,952	68,724,574	6,493,952	9.4%
Health	5,323,962	2,126,726	10,995,043	2,685,730	41,309,892	526,895	57,628,897	5,339,351	9.3%
Ministry of Local Government Administration	3,518,182	385,182	10,685,982	1,898,886	2,209,296	1,469,703	16,413,460	3,753,771	22.9%
Ministry of Labor and Social Welfare	738,064	544,593	3,990,465	747,757	2,140,008	27,335	6,868,537	1,319,685	19.2%
Agriculture and Rural Development	5,275,729	97,127	5,450,000	70,880	3,572,741	0	14,298,470	168,007	1.2%
<b>TOTAL</b>	<b>401,517,219</b>	<b>61,336,888</b>	<b>437,591,406</b>	<b>86,412,336</b>	<b>296,327,334</b>	<b>44,784,088</b>	<b>1,135,435,959</b>	<b>192,533,312 €</b>	<b>17.0%</b>



RAPORT MBI INVESTIMET KAPITALE  
NGA MINISTRITË E LINJËS NË  
KOMPETENCAT KOMUNALE  
PËR PERIUDHËN 2018 - 2020

